



REPUBLIKA E KOSOVËS

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

Komora Farmaceuta Kosova

Kosova Chamber of Pharmacists



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 84 Dt. 31.12.2019

R R E G U L L O R E

**PËR PËRCAKTIMIN E LLOJIT TË SHKELJEVE
ETIKE DHE PROCEDURAT E MBIKËQYRJES ETIKE
DHE PROFESIONALE**

Prishtinë, 2019

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1 , nënparagrafi 1.1. të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr/04/L-150, dhe nenit 20, paragrafi 1 të Statutit të OFK-së, në mbledhjen e mbajtur me 21/12/2019, nxjerr këtë

R R E G U L L O R E
PËR PËRCAKTIMIN E LLOJIT TË SHKELJEVE ETIKE DHE
PROCEDURAT E MBIKËQYRJES ETIKE DHE PROFESIONALE

Kapitulli I – Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1
Qëllimi

Rregullorja për procedurat e mbikëqyrjes etike dhe profesionale ka për qëllim përcaktimin kornizës procedurale për zbatimin efektiv të procedurave administrative që zhvillohen në dy shkallshmëri pranë Këshillit Etik dhe Gjyqit të Nderit të OFK-së. Po ashtu ky akt ka për qëllim precizimin e rolit dhe pozitës procedurale të Prokurorit të Odës në procedurat administrative që zhvillohen pranë organeve kompetente të OFK-së për mbikëqyrje etike dhe profesionale pranë OFK-së.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet vetëm gjatë zhvillimit të procedurave pranë organeve kompetente për mbikëqyrje etike dhe profesionale të OFK-së lidhur me përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve të OFK-së gjatë ushtrimit të profesionit të paraqiturit lidhur me respektimin e Kodit Etik dhe Deontologjisë të Farmacistit.

Neni 3
Përkufizimet

1. Termet dhe akronimet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1 **Prokurori** – nënkupton Prokurorin dhe zëvendësprokurorin e Odës si organ i paraparë me dispozitat e Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe Statutin e Odës;
 - 1.2 **Relatori** – nënkupton anëtarin e organit përkatës i cili caktohet sipas rënditjes alfabetike nga radha e anëtarëve të organit përkatës dhe i cili përgatit raportin fillestar të çështjes;

1.3 Dyshimi i bazuar – nënkupton rrethanën të mbështetur në prova të artikulueshme që do të bënin të bindshëm nga pikëpamja objektive se i paraqituri me veprimin apo mosveprimin e tij ka shkelur Kodin Etik, legjislacionin nga fusha e shëndetësisë apo Statutin e Odës;

- 1.4 **Provë e artikulueshme** – nënkupton dëshminë apo provën materiale e cila përnga përmbajtja ofron të dhëna që kanë relevancë për të vërtetuar gjendjen faktike dhe shkeljen e pretenduar;
 - 1.5 **Palët e autorizuara** – janë subjektet të cilat kanë të drejtë të paraqesin ankesë ndaj i paraqiturit për të cilin pretendojnë se ka vepruar në kundërshtim me ligjin, Statutin apo Kodin Etik;
 - 1.6 **Akti ankimor** – nënkupton ankesën apo kërkesën me të cilën iniciohet procedura disiplinore, e parashtruar nga palët e autorizuara;
2. Termet dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni, do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

Kapitulli II – Shkelja dhe përgjegjësia etike

Neni 4 Shkelja etike

Shkelja etike është veprim në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Farmaceutike dhe me këtë rregullore, veprim i cili është në kundërshtim me standardet dhe ndërgjegjen profesionale, tiparet e së cilës janë përcaktuar me dispozitat e Kodit Etik dhe kësaj rregullore dhe masat disiplinore për shkeljet të tilla që janë përcaktuar me ligj, Statutin e Odës dhe këtë Rregullore.

Neni 5 Mënyra e shkeljes etike

1. Shkelja etike mund të kryhet me veprim apo me mosveprim.
2. Shkelja etike kryhet me mosveprim vetëm atëherë kur shkelësi nuk e ka ndërmarrë një veprim të cilin ka qenë i obliguar që ta ndërmerr.

Neni 6 Përgjegjësia etike

1. Për shkeljen etike **Farmacisti-Profesionisti** është përgjegjës nëse në kohën e shkeljes etike ka pasë aftësi mendore dhe veprën penale e ka kryer në fajësi.
2. Profesionisti nuk është etikisht përgjegjës nëse në kohën e shkeljes nuk ka pasur afëti mendore që të gjykojë veprimin të cilin e ka ndërmarr.

3. Përshtatshëmrisht dispozitat për përjashtimin e përgjegjësive penale nga Kodi Penal do të zbatohen me rastin e konstatimit të përjashtimit të përgjegjësive etike.

Neni 7 **Format e fajsisë**

1. Shkelja etike mund të kryhet me dashje apo nga neglizhenca.
2. Shkelja etike është bërë me dashje nëse shkelësi ka qenë i vetëdijshëm për veprimin të cilit e ka ndërmarrë dhe dëshiron, respektivisht pajtohet me veprimin i cili është në kundërshtim me normat etike.
3. Shkelja etike është bërë nga neglizhenca nëse shkelësi nga mendjalehtësia mendon se nuk është duke vepruar në kundërshtim me normat etike, ndërsa ka qenë i obliguar që të jetë i vetëdijshëm se me veprimin e tillë është në kundërshtim me normat etike.

Neni 8 **Individualiteti i përgjegjësive etike**

1. I paraqituri bartë përgjegjësi individuale etike për veprimet apo mosveprimet që i ndërmerr me rastin e ushtrimit të veprimtarisë farmaceutike.
2. Në raste kur shkelja bëhet në bashkëveprim apo bashkëkryerje, secili farmacist është përgjegjës për veprimin apo mosveprimin e tij i cili është në kundërshtim me normat etike.

Kapitulli III – Klasifikimi i Shkeljeve Etike Dhe Matja e Dënimit

Neni 9 **Kategorizimi i shkeljeve etike**

1. Gjatë përcaktimit të masës disiplinore nga ana e organeve të mbikëqyrjes etike dhe profesionale, masat do të kategorizohen sipas shkeljes së kualifikuar,
 - 1.1. Shkelje të lehta
 - 1.2 Shkelje të rënda

Neni 10 **Shkeljet e lehta dhe shkeljet e rënda**

1. Shkelje të lehta konsiderohen shkeljet e dispozitave të Kodit Etik të OFK-së të cilat përcaktojnë se :
 - 1.1. Farmacisti gjatë punës së vet është gjithmonë në shërbim të pacientit;

- 1.2. Farmacisti duke e përdorur diturinë e tij profesionale do të ofroj kujdes dhe shërbime në mënyrë të vazhdueshme dhe me respekt ndaj pacientit;
- 1.3. Farmacisti përmes shkathtësive të komunikimit do të identifikojë pacientët me nevoja specifike dhe do të ofroj kujdes dhe shërbime bazuar në ato nevoja;
- 1.4. Farmacisti do të identifikoj rreziqet nga dëmet eventuale që pacienti mund të pësoj nga përdorimi i barnave dhe do të veproj në eliminimin e tyre; (në vartësi nga pasojat shkelja e tillë mund të klasifikohet edhe si shkelje e rëndë)
- 1.5. Farmacisti do të merret aktivisht me promovimin e shëndetit dhe mirëqenies së pacientit.
- 1.6. Farmacisti duhet që të respektoj të drejtën e pacientit për vendimmarrje në trajtimin etij;
- 1.7. Farmacisti duhet të ndërmer hapat e nevojshëm për komunikim efektiv me pacientit dhe të përshtat mënyrën e komunikimit me nevojat e pacientit;
- 1.8. Farmacisti duhet t'i sqaroj pacientit opsionet e mundshme të trajtimit apo kujdesit, duke përfshirë rreziqet dhe dobitë në mënyrë që pacientit t'i mundësohet zgjedhje e arsyeshme për të;
- 1.9. Farmacisti duhet të veproj në interesin më të mirë të pacientit.
- 1.10. Farmacisti duhet të përdor të gjitha burimet e mundshme në dispozicion për ofrimin e shërbimit profesional;
- 1.11. Farmacisti duhet të intervenoj dhe të komunikoj me profesionistët tjerë shëndetësor në rastet kur identifikon problem të mundshëm që do të cenonte trajtimin apo kujdesin e suksesshëm të pacientit;
- 1.12. Farmacisti në raste emergjente duhet të ndërmer hapat e nevojshëm për ofrimin e ndihmës ndaj pacientit dhe atë brenda kompetencave profesionale.
- 1.13. Farmacisti duhet që aktivisht të merr pjesë në zhvillimin dhe përparimin e profesionit;
- 1.14. Farmacisti duhet që të përkrah aktivitetet që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe përparimin e profesionit;
- 1.15. Farmacisti duhet që të identifikoj dhe adresoj nevojat e veta dhe të tjerëve në zhvillimin e vazhdueshëm profesional.
- 1.16. Farmacisti duhet që të komunikoj dhe bashkëpunoj me kolegë nga profesioni dhe nga profesionet tjera shëndetësore në të mirë të trajtimit apo kujdesit ndaj pacientit;
- 1.17. Farmacisti duhet të siguroj që veprimet apo sjelljet e tij nuk do të pengojnë punën profesionale të tjerëve;
- 1.18. Farmacisti duhet të siguroj që në vendin e punës të ketë procedurat e shkruara rreth ankesave të mundshme dhe të njoftoj palët për ato;
- 1.19. Farmacisti duhet të reagoj në rastet kur identifikon se procedurat, kushtet e punës apo performanca profesionale ndikojnë negativisht në sigurinë apo shëndetin e pacientit.
- 1.20. Farmacisti duhet të veproj me sinqeritet dhe integritet;
- 1.21. Farmacisti nuk do të përdor pozitën e tij profesionale me qëllim të shfrytëzimit të mungesës së njohurisë të tjerëve;
- 1.22. Farmacisti duhet që në mënyrë të hapur, të sinqertë dhe me kohë t'u përgjigjet ankesave dhe kritikave;
- 1.23. Farmacisti do të evitoj mundësinë e konfliktit të interesit dhe do t'a lajmëroj atë në të gjitha rastet;
- 1.24. Farmacisti do të siguroj që pacienti apo konsumatori nuk do të ketë qasje dhe mundësi që të ketë kontakt fizik me barnat të cilat përshkruhen me recetë që janë të ekspozuara në barnatore;

2. Në qoftë se shkeljet disiplinore të lehta përsëriten në një përvijdh më të afërt se 12 muaj atëhere kto shkelje kalojnë në shkelje me gjobitje.

3. Shkelje të rënda konsiderohen shkeljet e dispozitave të Kodit Etik të OFK-së të cilat përcaktojnë se :

- 3.1. Farmacisti duhet të ruaj dhe respektoj konfidencialitetin e informatave të siguruar rreth pacienti
 - 3.2. Farmacisti nuk duhet të përfshihet në marrëveshje apo marrëveshje biznesi e cila do t'a cenonte të drejtën e pacientit për përzgjedhje të trajtimit apo të kujdesit shëndetësor.
 - 3.3. Farmacisti gjatë marrjes së vendimit profesional nuk duhet të ndikohet në asnjë rrethanë nga interesi personal apo financiar;
 - 3.4. Farmacisti duhet të merr përgjegjësi për punën e kryer nga vet ai apo nga personi nën mbikqyrje të drejtpërdrejtë të tij;
 - 3.5. Farmacisti do të blej, shes apo promovoj vetëm ato produkte për të cilat është i sigurt se produktet i përmbushin kriteret e përcaktuara ligjore;
 - 3.6. Farmacisti në asnjë rast nuk do të veproj në atë mënyrë që të promovoj mbipërdorimin e barnave.
4. Shkelja e dispozitave të udhëzimit administrativ nr 02/2019 të MSH-së për rregullimin e çmimit të produkteve dhe paisjeve medicinale të cilat konsistojnë në abuzime me çmime të cilat janë objekt i rregullimit të këtij udhëzimi administrativ, klasifikohen si shkelje të rënda. Për këtë shkelje shqiptohet masa disiplinore e terheqjes së licencës.

Neni 11

Kategorizimi i masave disiplinore sipas llojit të shkeljes

1. Organi kompetent me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, për shkeljet të lehta do të shqiptojë masat disiplinore si në vijim:
 - 1.1. rekomandim kolegjial;
 - 1.2. kërkim falje ndaj pacientit;
 - 1.3. qortim ose qortim publik;

2. Me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, për shkeljet e rënda organi do të shqiptojë masat disiplinore si në vijim:
 - 2.1. arsimim shtesë dhe të detyrueshëm pasuniversitar dhe trajnim;
 - 2.2. trajtimi i detyrueshëm nga alkooli, droga dhe vese të tjera;

 - 2.3. tërheqja e përkohshme ose e përhershme e licencës dhe/ose fshirja e profesionistit shëndetësor nga regjistri;
 - 2.4. dënimi me të holla njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro për çdo shkelje të ligjit, detyrave profesionale dhe etike;

Neni 12

Rregullat e përgjithshme për matjen e masës disiplinore

1. Organi kompetent i Odës me rastin e caktimit të dënimit për shkeljen etike, do ta ketë parasysh kategorizimin e paraparë me këtë rregullore. Gjithashtu organi duhet ta ketë parasysh qëllimin e masës disiplinore dhe rrethanat në të cilat është bërë shkelja.
2. Masa disiplinore duhet të jetë në proporcion me peshën e shkeljes, pasojën e mundshme të shkaktuar dhe rrethanat në të cilat është kryer.
3. Me rastin e caktimit të masës disiplinore, organi merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme:
 - 3.1. shkallën e përgjegjësisë etike;
 - 3.2. motivet e shkeljes;
 - 3.3. dëmtimin e vlerës së mbrojtur;
 - 3.4. rrethanat në të cilat është bërë shkelja;
 - 3.5. sjelljen e mëparshme të shkelësit;
 - 3.6. pranimin e fajit dhe
 - 3.7. rrethanat profesionale të shkelësitit dhe sjelljen e tij pas shkeljes.
4. Organi kompetent me rastin e përcaktimit të masës disiplinore do ta ketë parasysh të kaluarën e shkelësit lidhur me recidivizmin etik, duke trajtuar rrethanat dhe natyrën e shkeljeve të mëparshme.
5. Në raste të shqiptimit të masës disiplinore të tërheqjes së përkohshme të licencës, tërheqja e tillë do të bëhet për periudhë kohore nga 3 (tre) muaj deri në 5 (pesë) vite. Rregulla e tillë është e zbatueshme edhe me rastin e shqiptimit të masës së fshirjes së farmacistit nga regjistri të cilin e mirëmban Oda.
6. Në rastet e shqiptimit të masës disiplinore të arsimimit shtesë dhe të detyrueshëm pasuniversitar dhe trajnimit, si dhe trajtimit të detyrueshëm nga alkooli, droga dhe veset të tjera, masa të tilla nuk do të shqiptohen në kohëzgjatje nga 3 (tre) muaj dhe jo më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj.
7. Vlerësimin e plotësimin të programit për masën disiplinore të arsimimit shtesë dhe të detyrueshëm pasuniversitar dhe trajnimit, do ta bëjë Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional. Me këtë rast Komisioni gjegësisht nxjerrë vërtetimin me të cilin bënë barazvlerësimin e programit arsimor apo trajnues me detyrimin e përcaktuar në vendimin e organit që ka shqiptuar masën e tillë disiplinore.
8. Mbikëqyrjen e zbatimit të masave të shqiptuara disiplinore e bën Këshilli Etik i Odës.

Neni 13

Masat disiplinore për bashkim të shkeljeve

1. Në raste kur i paraqituri me një apo më shumë veprime bën disa shkelje etike për të cilat zhvillohet procedura disiplinore, organi kompetent i cili zhvillon procedurën së pari shpall masat disiplinore për secilën shkelje veçmas për secilën shkelje dhe më pas e shqipton masën e përbërë disiplinore për të gjitha shkeljet.
2. Organi kompetent për zhvillimin e procedurës disiplinore shqipton masën e përbërë dhe unike disiplinore në bazë të këtyre rregullave:
 - 1.1 Nëse për ndonjërin nga shkeljet shqipton masën e revokimit të përhershëm të licencës, atëherë e shqipton vetëm këtë masë disiplinore;
 - 1.2 Nëse për secilën shkelje shqipton gjobën, masa unike disiplinore nuk mund ta tejkaloj dyfishin e maksimumit të përgjithshëm të gjobës; dhe
 - 1.3 Nëse për disa nga shkeljet shqipton gjobën dhe për shkelje të tjera shqipton revokimin e licencës, atëherë shuma e përgjithshme e gjobës nuk mund të jetë më e lartë se maksimumi i përgjithshëm dhe revokimi i licencës nuk mund të caktohet për kohëzgjatje më shumë se 5 (pesë) vite;
2. Varësisht nga lloji i shkeljeve, organi mund të shqiptojë masa të përbëra disiplinore duke shqiptuar për secilin grup të shkeljeve masën adekuate disiplinore.

Kapitulli IV – Parimet e përgjithshme të procedurës

Neni 14

Parimi i ligjshmërisë

1. Organet e mbikëqyrjes etike dhe profesionale gjatë zhvillimit të procedurave mbi vërtetimin e përgjegjësisë etike dhe profesionale të paraqiturit që është subjekt i procedurës së tillë, do të veprojnë në pajtim me legjislacionin në fuqi, Statutin e Odës, akteve normative të Odës, akteve të brendshme vetërregulluese dhe këtë rregullore.
2. Me rastin e ndërmarrjes së veprimeve procedurale organet kompetente për mbikëqyrjen etike dhe profesionale, veprimet e tilla do t'i mbështesin në legjislacionin në fuqi, Statutin e Odës, aktet normative të Odës, akteve të brendshme vetërregulluese dhe këtë rregullore.

Neni 15

Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit

1. Palët në procedurën pranë organeve të mbikëqyrjes etike dhe profesionale janë të barabarta dhe duhet të trajtohen pa diskriminim.

2. Dallimi në trajtimin e çështjeve justifikohet vetëm nëse dhe për aq sa ai përputhet me ndryshimet objektive të çështjeve përkatëse.

Neni 16

Parimi i objektivitetit dhe paanësisë

1. Organet e mbikëqyrjes etike dhe profesionale gjatë zhvillimit të procedurës janë të detyruara që të veprojnë në mënyrë objektive dhe të paanshme.
2. Në procedurën që zhvillohet pranë organeve të mbikëqyrjes etike dhe profesionale, anëtarët e këtyre organeve do t'i shmangen çfarëdo konflikti të interesi duke mos u ndikuar nga ndonjë interes personale, familjar, politik apo çfarëdo ndikimi që do të mund të cenonte objektivitetin dhe paanshmërinë e organit.

Neni 17

Parimi i prezumimit të pafajsisë

Pala kundër të cilës është iniciuar procedura për vërtetimin e përgjegjësisë etike dhe profesionale do të konsiderohet e pafajshme deri në nxjerrjen e vendimit e organit kompetent që ka marrë formën e prerë me të cilin është vërtetuar përgjegjësia etike dhe profesionale.

Neni 18

Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme

Veprimet e organeve të mbikëqyrjes etike dhe profesionale duhet të jenë të parashikueshme dhe të jenë në kuadrin e pritshmërisë të respektimit të parimeve të përgjithshme ligjore dhe të parimeve të përkufizuara me këtë rregullore.

Neni 19

Parimi i efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës

1. Organet në zbatim të procedurave të parapara me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Statutin, aktet normative të Odës dhe këtë rregullore do të zbatohen sipas afateve të parapara ligjore dhe në bazë të arsyeshmërisë për veprimet për të cilat nuk janë përcaktuar afatet në mënyrë taksative.
2. Me rastin e zbatimit të procedurës, organet kompetente do të kujdesen që palëve mos t'i shkaktohen shpenzimet e panevojshme. Veprimet procedurale do të jenë të kufizuara mbi bazën e nevojës të qëllimit të procedurës që zhvillohet.

Kapitulli V – Kompetenca e Mbikëqyrjes Etike dhe Profesionale

Neni 20

Kompetenca territoriale

1. Këshilli Etik është organi kompetent për shqyrtimin dhe vërtetimin e shkeljes etike dhe profesionale si organ i shkallës së parë, për të gjitha ankesat e palëve të autorizuar sipas kësaj rregulloreje, për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Gjyqi i Nderit është organ i shkallës së dytë i cili vendos për të gjitha ankesat me të cilat goditen vendimet e shkallës së parë, për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 21

Kompetenca lëndore

1. Këshilli Etik në procedurë disiplinore vendos brenda kufijve të kompetencës lëndore të caktuar me ligjin në fuqi, Statutin, rregulloren e mbrendshme dhe këtë rregullore.
2. Këshilli Etik në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni shqyrton të gjitha ankesat e parashtruara nga palët e autorizuar që kanë të bëjnë me shkelje të legjislacionit nga fusha e shëndetësisë, Statutin e Odës dhe Kodin Etik.

Neni 22

Kompetenca funksionale

1. Këshilli Etik është organi kompetent për shqyrtimin e ankesave të palëve të autorizuar si organ i shkallës së parë. Këshilli Etik po ashtu ka kompetencë funksionale për të vendosur mbi kërkesat për rihapje të procedurës si mjet i jashtëzakonshëm në procedurë të rregullt administrative.
2. Gjyqi i Nderit është organ i shkallës së dytë i cili vendos mbi mjetin juridik me të cilin goditen vendimet e organit të shkallës së parë në procedurë të rregullt administrative.

Neni 23

Kompetenca personale

Procedura disiplinore për shkeljet etike zbatohen nga organet kompetente të Odës për mbikëqyrjen etike dhe profesionale ndaj të gjithë farmacistve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Kosovës.

Kapitulli IV – Përrjashtimi i anëtarëve të organeve të mbikëqyrjes etike dhe profesionale

Neni 24

Shkaqet e përjashtimit

1. Anëtar i Këshillit Etik, Gjyqit të Nderit apo Prokurori, nuk mund të ndërmarrin veprime procedurale në çështjen konkrete të proceduar pranë organit kompetent, nëse:
 - 1.1. Kur me palën, me përfaqësuesin ligjor apo me të autorizuarin e palës, është në gjini të gjakut në vijë të drejtë deri në cilëndo shkallë, kurse në vijë të tërthortë deri në shkallë të katërt, apo në qoftë se është bashkëshort apo në gjini të krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesë ka pushuar ose jo;
 - 1.2. kur bashkëshorti apo partneri bashkëjetues, apo të afërmit e tij deri në shkallë të dytë, kanë një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë;
 - 1.3. kur është vetë palë, përfaqësues ligjor apo i autorizuar i palës, apo me palën është kreditor apo bashkëkreditor, debitor apo bashkëdebetor, apo në qoftë se në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar apo si ekspert, apo ka marrë pjesë në procedurë si këshilltar apo avokat i palës;
 - 1.4. anëtar i organit apo personat e parashikuar nga nënparagrafi 1.2. i këtij neni, kanë një interes direkt apo indirekt në një çështje të ngjashme me çështjen në fjalë;
 - 1.5. personat e përmendur në nënparagrafin 1.2. të këtij neni, kanë marrë pjesë si ekspertë, dëshmitarë, këshilltarë apo avokatë në çështjen në fjalë;
 - 1.6. ndërmjet anëtarit të organit apo personave të përmendur në nënparagrafin 1.2. të këtij neni, ka një proces gjyqësor me palët;
 - 1.7. nëse është pjesë apo shqyrton si organ epror ankesën e një akti të marrë prej vetë atij, ose nga personat e përmendur në nënparagrafin 1.2 të këtij neni;
 - 1.8. me palën, përfaqësuesin apo të autorizuarin e palës, është në marrëdhënie të kujdestarit, birësuesit apo të ushqyesit;
 - 1.9. në çdo situatë tjetër, parashikuar shprehimisht me ligj apo që mund të vë në

dyshim paanshmërinë e tij.

2. Anëtari i organit nga paragrafi 1 i këtij neni është i obliguar që të kërkojë përjashtimin e tij gjatë trajtimit të rastit në cilëndo kohë që vihet në dijeni për ekzistimin e ndënjërës nga rrethanat e përcaktuara sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Kërkesa i parashtrohet organit i cili vendos për kërkesat e palëve për përjashtim sipas Nenet 27 të kësaj rregulloreje.

Neni 25

Kërkesa për përjashtim

1. Palët në procedure mund të parashtrojnë kërkesën për përjashtimin e anëtarit të organit pranë të cilit zhvillohet procedura disiplinore, posa të vihet në dijeni për ekzistimin e ndonjëres nga rrethanat që bien në dyshim paanshmërinë apo paanësinë e tij.
2. Kërkesa për përjashtim të anëtarit të organit parashtrohet deri në përfundimin e çështjes me vendim të formës së prerë.
3. Organi kompetent për vendosje lidhur me përjashtimin e anëtarit të organit duhet të vendos për kërkesën e parashtruar në afat prej 5 (pesë) ditëve nga parashtrimi i kërkesës.

Neni 26

Kompetenca për vendosje lidhur me përjashtimin

1. Për kërkesat lidhur me përjashtimin e anëtarit të organit, vendoset sipas mënyrës në vijim:
 - 1.1 Për kërkesat që kanë të bëjnë me përjashtimin e anëtarit të Këshillit Etik, vendos Kryetari i Këshillit Etik;
 - 1.2 Për kërkesat që kanë të bëjnë me përjashtimin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit të Këshillit Etik, vendos Gjyqi i Nderit;
 - 1.3 Për kërkesat që kanë të bëjnë me përjashtimin e anëtarëve të Gjyqit të Nderit vendos Kryetari i Gjyqit të Nderit;
 - 1.4 Për kërkesat që kanë të bëjnë me përjashtimin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit të Gjyqit të Nderit, vendos Kryetari i Odës;
 - 1.5 Për kërkesat që kanë të bëjnë me përjashtimin e Prokurorit apo Zëvendësprokurorin, vendos Kryetari i Odës.
2. Në rastet e përjashtimit të një anëtari të organit kolegjal, organi funksionon si i tillë pa pjesëmarrjen e anëtarit të përjashtuar. Kuorumi dhe vendimmarrja llogaritet pa marrë në konsideratë vendin apo votën e anëtarit të përjashtuar.

3. Zëvendësimi Prokurorit dhe Zëvendësprokurorit si organe individuale, bëhet me propozimin e Kryetarit të Odës, i miratuar nga Këshilli Drejtues. Ushtruesi i detyrës të Prokurorit dhe Zëvendësprokurorit ndërmerr veprimet vetëm në çështjen për të cilën është bërë zëvendësimi deri në përfundimin e çështjes me vendim të formës së prerë.

Kapitulli III – Subjektet e procedurës disiplinore

Neni 27

Palët në procedurë

1. Palët në procedurë pranë organeve të mbikëqyrjes etike dhe profesionale janë:
 - 1.1 Parashtruesi i ankesës;
 - 1.2 Prokurori i Odës;
 - 1.3 Pala e dëmtuar;
 - 1.4 Palët e autorizuar sipas dispozitës së Nenit 32 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor.
2. Në bazë të dispozitave të këtij rregullore, në procedurën e zhvilluar pranë organeve kompetente të Odës për mbikëqyrje etike dhe profesionale, palët që iniciojnë procedurën sipas ankesës do të përfaqësohen nga Prokurori i Odës.

Neni 28

Zotësia e palëve dhe përfaqësimi

1. Në procedurë pranë organeve të mbikëqyrjes mund të paraqitet çdo person fizik dhe juridik në cilësi të palës së autorizuar në përputhje me dispozitat e Nenit 32 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor.
2. Personi fizik në cilësi të palës në procedurë ka zotësi të veprimit nëse është në moshë madhore apo e ka fituar zotësinë .
3. Përfaqësimi i personave pa zotësi të veprimit bëhet në pajtim me rregullat e Ligjit për Procedurën Kontestimore në përputhje me referimin ligjor nga Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
4. I paraqituri ndaj të cilit është filluar procedura disiplinore mund të kërkojë nga Oda që të angazhojë profesionistin nga lëmia juridike dhe që është i angazhuar në Shërbimin Profesional për ta përfaqësuar të paraqiturin sipas detyrës zyrtare.

Neni 29
Kompetencat dhe përgjegjësitë e Prokurorit të Odës

1. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Prokurorit të Odës janë:
 - 1.1 Ndërmerr veprimet që janë të nevojshme për hetimin e shkeljes etike dhe profesionale;
 - 1.2 Siguron informacione për nevojat e vërtetimit të ekzistimit të dyshimit të arsyeshëm lidhur me shkeljen mbi të cilën rëndon dyshimi;
 - 1.3 Shqyrton ankesat e palëve të dëmtuara dhe varësisht nga baza provuese paraqetë propozim-ankesën pranë Këshillit Etik apo e hedhë si të pabazuar ankesën;
 - 1.4 Inicion procedurat disiplinore-etike sipas detyrës zyrtare dhe varësisht nga rezultati hetimorë paraqet fletëparaqitje ndaj të paraqiturit pranë Këshillit Etik;
 - 1.5 Përfaqëson propozim-ankesën dhe fletëparaqitjen sipas detyrës zyrtare në procedurë pranë Këshillit Etik dhe Gjyqit të Nderit;
 - 1.6 Ushtron mjetin e rregullt juridik pranë Gjyqit të Nderit;
 - 1.7 Bashkëpunon me organet të tjera të Odës dhe institucionet publike lidhur me ushtrimin e kompetencave të tij; dhe
 - 1.8 Ndërmerr veprimet të tjera të parapara me këtë rregullore.
2. Kompetencat nga paragrafi 1 i këtij neni ushtrohen edhe nga zëvendësprokurori i Odës me autorizim të Prokurorit të Odës. Prokurori i Odës mund ta organizojë menaxhimin e lëndëve të pranuar me kordinim me zëvendësprokurorin për ndarje të lëndëve mbi baza të rregullta pa pasur nevojë për autorizim paraprak.

Kapitulli IV – Inicimi i procedurës

Neni 30
Inicimi i procedurës

1. Procedura disiplinore ndaj të paraqiturit inicohet në bazë të ankesës së palës së dëmtuar dhe kërkesës të institucioneve publike që janë përkufizuar me dispozitat e Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Statutin dhe këtë rregullore.

2. Anëtari i OFK-së me rastin e inicimit të procedurës disiplinore obligohet të paguaj taksën procedurale në shumën e përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues.
3. Ankesat e parashtruara nga pala e dëmtuar procedohet për shqyrtim pranë Prokurorit, i cili në bazë të veprimeve hetimore nxjerrë përfundimin lidhur me ekzistimin apo jo të dyshimit të bazuar se i paraqituri ka vepruar në kundërshtim me normat etike dhe profesionale.
4. Ankesat apo kërkesat e parashtruara nga institucionet publike procedohen drejtpërdrejt pranë Këshillit Etik dhe ndaj të njëjtave ekziston prezumimi i ekzistimit të dyshimit të bazuar.

Neni 31

Përmbajtja e ankesës dhe parashtrësive në procedurë

1. Ankesa e palëve, mjeti juridik, përgjigja në ankesë, kërkesa për rihapje të procedurës, si dhe parashtrësia të tjera që paraqiten gjatë zhvillimit të procedurës, duhet të paraqiten me shkrim.
2. Parashtrësia nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas tyre. Ato duhet të përmbajnë sidomos: emrin e organit që i drejtohen, emrin dhe mbiemrin (emërtimin e personit juridik), vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor apo me prokurë, po që se i kanë, çështjen të cilës i referohen, përmbajtjen e deklaratës dhe nënshkrimin e parashtruesit (formulari).
3. Dështimi i përmbushjes së kushteve nga paragrafi 2 e bën parashtrësën si jo të plotë dhe si e tillë konsiderohet se është tërhequr, nëse pala dështon ta plotësojë atë sipas afatit të dhënë për plotësimin e saj (7 ditë)

Neni 32

Shqyrtimi i ankesave nga Prokurori i Odës

1. Çdo ankesë e parashtruar nga palët e dëmtuara paraprakisht shqyrtohet nga Prokurori i Odës, i cili është i obliguar që të vërtetojë se a ekziston dyshimi i bazuar për pretendimet të cilat janë përfshirë në ankesën e parashtruar.
2. Gjatë shqyrtimit të ankesës së parashtruar Prokurori i Odës merrë parasysh bazën provuese dhe sipas diskrecionit nxjerrë përfundim se a ekziston dyshimi i bazuar për shkeljen e prentuar. Në rast se Prokurori i Odës konsideron se ekziston dyshimi i bazuar se i paraqituri ndaj të cilit është paraqitur ankesa ka vepruar në kundërshtim me Kodin Etik dhe aktet tjera, Prokurori i Odës përpilon propozim-ankesën të cilën e procedon pranë Këshillit Etik.

3. Në kuadrin e kompetencave Prokurori i Odës mund të hetojë shkeljen eventuale të paraqiturit dhe me këtë rast me qëllim të vërtetimit të ekzistimit apo jo të dyshimit të bazuar, sipas përfundimeve të arritura gjatë hetimit, respektivisht gjatë mbledhjes së informatave të paraqet fletëparaqitjen pranë Këshillit Etik.
4. Autorizimet nga ky nen mund të ushtrohen edhe nga zëvendësprokurori i Odës.

Neni 33

Procedura hetimore

1. Prokurori i Odës fillon procedurën hetimore në momentin që pranon ankesën nga pala e dëmtuar apo edhe kur vihet në dijeni se është bërë shkelja nga i paraqituri i cili është anëtar i Odës.
2. Procedurën hetimore e fillon Prokurori pa pasur nevojë që të nxjerrë vendim të veçantë mbi fillimin e hetimeve.
3. Procedura hetimore nuk mund të zgjasë më gjatë se 6 (gjashtë) muaj nga dita kur është pranuar ankesa, tek rastet e shqyrtimit të ankesave nga palët e dëmtuara. Në raste të tilla, hetimi pushon sipas fuqisë juridike (ex iuris).
4. Për hetimet Prokurori i çështjes i kufizon hetimet sipas afatit të parashkimit të çështjes, siç në afat prej 60 ditësh nga fillimi i hetimit.

Neni 34

Hudhja e ankesës

1. Prokurori i Odës me aktvendim e hudhë ankesën e parashtruar nga pala në rast se nga aktiviteti hetimor rezulton se:
 - 1.1 Nuk ekziston dyshimi i bazuar se është bërë shkelja etike;
 - 1.2 Ka kaluar afati për inicim të procedurës; ose
 - 1.3 Ekzistojnë rrethanat të tjera që e bëjnë përjashtimin e përgjegjesisë etike.
2. Aktvendimi nga paragrafi 1 i këtij neni i dërgohet palës e cila ka parashtruar ankesën jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga nxjerrja e të njëjtit.
3. Pala e pakënaqur me aktvendimin e Prokurorit të Odës mund të parashtrojë ankesë pranë Këshillit Etik në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.

Neni 35
Procedimi i çështjes në Këshill Etik

1. Prokurori i Odës pas zhvillimit të hetimeve sipas Nenit 34 të kësaj rregulloreje i paraqet Këshillit Etik propozim-ankesën apo fletëparaqitjen së bashku me të gjitha materialet provuese.
2. Procedimi i çështjes pranë Këshillit Etik sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet menjëherë pas nxjerrjes së fletëparaqitjes apo propozim-ankesës.
3. Ankesat e parashtruara nga Prokuroria e Shtetit, Inspektorati Shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë apo ndonjë institucion publik, trajtohen drejtpërdrejt nga Këshilli Etik dhe të njëjtat nuk i përfaqëson Prokurori. Ankesat e tilla procedohen në mënyrë të njëjtë sikurse aktet ankimore të Prokurorit dhe për ankesat të njëjta ftohet në seancë përfaqësuesi i institucionit për përfaqësimin e pretendimeve ankimore.

Neni 36

1. Në propozim-ankesën apo fletëparaqitjen, Prokurori i Odës bën kualifikimin paraprak të shkeljes etike për të cilën ekziston dyshimi i bazuar se është bërë nga i paraqituri. Këshilli Etik nuk është i lidhur domosdoshmërisht për kualifikimin e bërë në propozim-ankesë apo fletëparaqitjen e Prokurorit të Odës dhe gjatë shqyrtimit dhe vendosjes për çështjen për të cilën është duke u zhvilluar procedura mund të bëjë rikualifikimin poqë se gjendja faktike i përgjigjet një forme tjetër etike të sanksionuar me Kodin Etik.
2. Prokurori i Odës në propozim-ankesë apo fletëparaqitje mund t'i propozojë Këshillit Etik shqiptimin e masës konkrete disiplinore. Këshillit Etik në rastin e propozimit të Prokurorit të Odës për shqiptimin e masës disiplinore nuk është i lidhur dhe për këtë mund të vendosë shqiptimin e ndonjë mase tjetër që i përgjigjet shkeljes e cila është vërtetuar se është kryer.

Neni 37

Përmbajtja e fletëparaqitjes dhe propozim-ankesës

1. Propozim-ankesa dhe fletëparaqitja e Prokurorit të Odës përpilohet në formë të shkruar dhe së paku duhet të përfshinë:
 - 1.1 Emrin dhe mbiemrin, numrin e telefonit kontaktues, adresën e vendbanimit apo vendqëndrimin të palës që ka parashtruar ankesën, në rast të fletëparaqitjes;

- 1.2 Emrin dhe mbiemrin, numrin e telefonit kontaktues, adresën e vendbanimit apo vendqëndrimin të paraqiturit ndaj të cilit është vënë dyshimi se ka bërë shkeljen;
- 1.3 Përshkrimi i veprimit apo mosveprimit me të cilin pretendohet se është bërë shkelja;
- 1.4 Saktësimi i provave dhe dëshmive të mbledhura nga Prokurori i Odës;
- 1.5 Arsyetimi për ekzistimin e dyshimit të bazuar në bazë të përfundimit të Prokurorit të Odës;
- 1.6 Kualifikimi i shkeljes dhe propozimi për shqiptimin e masës disiplinore; dhe
- 1.7 Data dhe nënshkrimi i Prokurorit të Odës.

Neni 38 **Pezullimi i procedurës**

1. Prokuroi i Odës me aktvendim mund të pezullojë procedurën hetimore në raste të shkeljes së lehtë dhe kur i paraqituri ndaj të cilit është parashtruar ankesa shprehë vullnetin që të korigjojë veprimin e ndërmarrë, duke përfshirë kompensimin e dëmit eventual të shkaktuar me veprimin apo mosveprimin e të njëjtit.
2. Pezullimi i procedurës mund të bëhet në kohëzgjatje deri në 1 (një) vit dhe periudha e tillë kohore konsiderohet kohëzgjatje brenda së cilës i paraqituri duhet t'i ndërmerr veprimet korigjuese. Prokurori i Odës ka të drejtë që të bëjë verifikimin e korigjimit dhe se vlerësimin për përmbushje do ta bëjë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e skadimit të afatit nga ky paragraf.
3. Periudha e pezullimit të procedurës e ndërpre në afatin e parashkrimit dhe në rast të mospërmbushjes së kushteve nga aktvendimi për pushim të procedurës, Prokurori i Odës mund të iniciojë procedurën pranë Këshillit Etik sipas rrjedhës së afatit të parashkrimit në gjendjen para nxjerrjes së akteve ndimit nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 39 **Shqyrtimi fillestar nga Këshilli Etik**

1. Nga paraqitja e propozim-ankesës apo fletëparaqitjes së Prokurorit të Odës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, një nga anëtarët e Këshillit Etik, sipas rradhës alfabetike në rotacion,

në cilësi të relatorit do të përgatisë një raport me të cilin bënë përshkrimin e ngjarjes dhe të gjeturat me rekomandimet për çështjen në fjalë.

2. Raporti i anëtarit relator i dërgohet të gjithë anëtarëve të Këshillit Etik dhe në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve Kryetari i Këshillit Etik cakton datën e mbajtjes së seancës të shqyrtimit kryesor.
3. Kryetari i Këshillit Etik para se të caktojë seancën e shqyrtimit kryesor, raporti i relatorit merr aprovimin formal me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të Këshillit Etik. Votimi i tillë bëhet me votim qarkullues. Votimi ka të bëjë me bazueshmërinë e aktit të ngritur nga Prokurori i Odës.
4. Në rast se të refuzimit të bazueshmërisë së aktit, Kryetari i Këshillit Etik konstaton se nuk ekziston baza për shqyrtim të mëtutjeshëm të çështjes dhe në këtë mënyrë Këshilli Etik nxjerrë aktvendimin e arsyetuar me të cilin e hedhë propozim-ankesën apo fletëparaqitjen e Prokurorit të Odës.

Neni 40

Njoftimi i palëve dhe dërgimi i ftesave

1. Palët në procedurën e shqyrtimit etik ftohen të paktën 8 (tetë) ditë para mbajtjes së seancës të shqyrtimit kryesor.
2. Afati nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohet për të gjitha njoftimet të tjera në komunikimin e Këshillit Etik me palët në procedurë.
3. Ftesa e dërguar palëve përmbanë datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës të shqyrtimit kryesor, cilësinë e të ftuarit në procedurë dhe emërtimin e përgjithshëm të çështjes.
4. Në ftesë po ashtu pranuesit të ftesës i bëhet me dije se:
 - 4.1 e drejta që të përfaqësohet nga përfaqësuesi ligjor apo me prokurë;
 - 4.2 se seanca e shqyrtimit kryesor nuk shtyhet për shkak të mospranisë së tij apo përfaqësuesit të autorizuar; dhe
 - 4.3 I paraqituri ndaj të cilit fillohet procedura disiplinore ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për angazhim të përfaqësuesit nga Shërbimi Profesional i Odës.

5. Shërbimi profesional është i obliguar që të dërgojë ftesat tek palët. Në pamundësi të dërgimit të ftesave në formë të shkruar, zyrtari i Shërbimit Profesional mund t'i thërret palët edhe përmes komunikimit telefonik dhe postës elektronike. Në rast të njoftimit të palëve përmes telekomunikimit, zyrtari evidenton thirrjen në procesverbal duke shënuar të dhënat personale të palës, numrin kontaktues, datën dhe kohën e realizimit të thirrjes. Ndërkaq në rast të dërgimit të ftesës me postë elektronike, zyrtari në ftesën e bashkëngjitur kërkon nga pranuesi që të konfirmojë pranimin e kërkesës. Në rast të mospërgjigjes brenda 24 orëve nga dërgimi i postës elektronike, zyrtari do të përpiqet që ta kontaktojë pranuesin përmes komunikimit telefonik.
6. Pas aprovimit formal të aktit ankimor nga Këshilli Etik sipas Nenit 40 të kësaj rregulloreje, me rastin e dërgimit të ftesës për shqyrtim kryesor sipas këtij neni, të paraqiturit së bashku me ftesën do t'i dërgohet akti i ngritur ankimor së bashku me materialin provues në të cilin mbështet akti i tillë.

Neni 41 **Shqyrtimi kryesor**

1. Shqyrtimi kryesor caktohet me urdhër të Kryetarit të Këshillit Etik, në të cilin shënohet pranueshmëria për shqyrtim e propozim-ankesës apo fletëparaqitjes së Prokurorit. Po ashtu në urdhër të Kryetarit të Këshillit Etik shënohet data, koha dhe vendi i mbajtjes së seancës dhe rregullore për Shërbimin Profesional për të dërguar ftesat për palët.
2. Konsiderohet se janë përmbushur kushtet për mbajtjen e seancës të shqyrtimit kryesor nëse ftesat u janë dërguar palëve në mënyrë të rregullt dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për ndërmarrjen e veprimeve procedurale për fillimin e seancës.

Neni 42 **Seanca e shqyrtimit kryesor**

1. Seanca e shqyrtimit kryesor fillon me hapjen të cilën e bën Kryetari i Këshillit Etik.
2. Në hapjen e seancës së shqyrtimit kryesor Kryetari i Këshillit Etik prezanton anëtarët e Këshillit Etik dhe Prokurorin e çështjes, paraqet në mënyrë të përgjithshme rastin dhe mënyrën e inicimit të çështjes, konstaton dërgimin të rregullt apo jo të ftesave dhe praninë e palëve në seancë dhe i njofton palët me të drejtat themelore në procedurë.
3. Kryetari i Këshillit Etik pas hapjes së seancës udhëzon të paraqiturin si në vijim:

3.1 për të drejtën e tij mos të deklarohet dhe të mbrohet në heshtje;

- 3.2 për të drejtën e tij që të paraqesë mbrojtjen e tij personalisht apo përmes përfaqësuesit të tij duke u deklaruar për të gjitha faktet që ai i konsideron si të rëndësishme për çështjen;
 - 3.3 t'i marrë në pyetje dëshmitarët e propozuar nga Prokurori dhe palët të tjera si dhe të propozojë dëshmitarët në favor të mbrojtjes së tij;
 - 3.4 për deklaratimet që konsideron që mund ta inkriminojnë përgjegjësinë e tij të refuzojë deklaratimin e tillë;
 - 3.5 të drejtën për tu përfaqësuar personalisht apo përmes mbrojtësit të autorizuar; dhe
 - 3.6 të drejtën mbi përkthimin në gjuhën e tij amëtare të deklaruar nga ai.
4. Pas udhëzimeve të dhëna, Kryetari i Këshillit Etik e thërret Prokurorin që të bëjë leximin e propozim-ankesës apo fletëparaqitjes sipas përmbajtjes së tyre.
 5. Pas leximit të aktit të Prokurorit, Kryetari i Këshillit Etik e fton palën ndaj të cilit është ngritur akti ankimor se a i ka kuptuar pretendimet e Prokurorit dhe se a ka nevojë për ndonjë sqarim shtesë lidhur me aktin ankimor.
 6. Pas leximit të aktit ankimor nga paragrafi 4 i këtij neni, Kryetari i Këshillit fton të paraqiturin që të deklarohet lidhur me pretendimet në aktin ankimor dhe ta bëjë një elaborim lidhur me çështjen. I paraqituri me rastin e deklaratimit ka të drejtë të ofrojë të dhëna dhe materiale të cilat klasifikohen si material provues nga ana e Këshillit Etik.
 7. Në rast të mungesës së Prokurorit apo të paraqiturit, seanca vazhdohet me dëgjimin e palës së dëmtuar nëse është e pranishme, dëshmitarëve dhe ekspertëve, nëse janë angazhuar në çështjen konkrete, si dhe administrimin të provave të propozuara për shqyrtim. Para dëgjimit të dëshmitarëve dhe administrimit të provave, Kryetari i Këshillit Etik bën leximin formal të aktit ankimor dhe më pas vazhdon me procedim sipas radhës së përcaktuar me këtë rregullore.

Neni 43

Radha e të provuarit në shqyrtim kryesor

1. Në shqyrtim kryesor provat prezantohen sipas radhës së mëposhtme:
 - 1.1 Provat e parashtruara nga Prokurori;

- 1.2 Provat e parashtruara nga pala e dëmtuar;
 - 1.3 Provat e parashtruara nga i paraqituri apo përfaqësuesi i tij; dhe
 - 1.4 Deklarata përfundimtare e Prokurorit, palës së dëmtuar dhe e paraqiturit.
2. Në rast të mungesës së palëve në procedurë, Kryetari i Këshillit Etik do të bëjë leximin e provave dhe do të bëjë dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar nga palët sipas radhës së përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 44

Palët që ftohen në shqyrtim kryesor

1. Në shqyrtim kryesor ftohet Prokurori nëse është iniciuar procedura me aktin ankimor, pala e dëmtuar, dëshmitarët dhe ekspertët e angazhuar në çështjen konkrete.
2. Në raste kur procedura iniciohet me ankesën e institucioneve publike që paraqiten si palë të autorizuar në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje, ftohet përfaqësuesi i institucionit që ka parashtruar ankesën.
3. Seanca e shqyrtimit kryesor ka karakter të mbyllur, me përjashtim kur me leje të Kryetarit të Këshillit Etik lejohet pjesëmarrja e përfaqësuesit të organizatës nga shoqëria civile që ka interes juridik për të përcjellë çështjen.
4. Anëtarët e familjes së pacientit lejohen të marrin pjesë në shqyrtim gjyqësor, por në numër të kufizuar dhe jo më tepër se dy anëtarë të familjes.
5. Para fillimit të seancës të gjithë të pranishmit nënshkruhen në listën e pjesëmarrësve në seancë.

Neni 45

Evidentimi i seancës

1. Seancat e shqyrtimit kryesor incizohen në audio format.
2. Në bazë të audio materialit Shërbimi Profesional përpilon procesverbalin i cili nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Etik dhe procesmbajtësi i cili e ka transkriptuar në formë të shkruar rrjedhën e seancës.

3. Kryetari i Këshillit Etik mund të kontekstualizojë dhe të përzgjedhë deklaratimet e palëve në procedurë sipas relevancës. Në rast se deklaratimet nuk janë reëvante për çështjen, ato mund të mos përfshihen në procesverbalin e përpiluar.
4. Procesverbali përpilohet jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga dita e mbajtjes së seancës dhe i njëjti u dërgohet palëve në formë elektronike si dhe në formë të shtypur në seancën e ardhshme. Në rast se pranimi i procesverbalit në formë elektronike konfirmohet nga pala, dorëzimi në formë të shtypur nuk dorëzohet.

Neni 46 **Rendi në seancë**

1. Kryesuesi i seancës mban rendin gjatë zhvillimit të seancës e deri në përfundimin e saj.
2. Në rast të prishjes së rendit dhe qetësisë në seancë apo mospërfilljes ndaj urdhërimeve të shqiptuara në seancë nga kryesuesi i seancës, palës i kërkohet t'i ndalojë veprimet e tilla. Në rast të mospërfilljes, kryesuesi kërkon nga pala që ta lëshojë sallën ku mbahet seanca.
3. Kryesuesi në konsultim me anëtarët e Këshillit Etik që janë të pranishëm në seancë, mund të kërkojë përjashtimin e mborjtësitë të autorizuar apo atë me prokurorë për shkak të mosbindjes dhe prishjes së rendit dhe qetësisë në seancë.
4. Në rast të përjashtimit të përfaqësimit sipas detyrës zyrtare, përfaqësuesit të tillë mund t'i shqiptohet masa e ndalesës së përfaqësimit deri në 1 (një) vit nga dita e shqiptimit të masës.
5. Në rast të përjashtimit të përfaqësuesit, i paraqituri mund të kërkojë shtyrjen e seancës deri në 8 (tetë) dita nga dita e seancës kur është shqiptuar një masë e tillë, për të siguruar mbrojtës tjetër. Tek rasti i përfaqësimit sipas detyrës zyrtare, për përjashtim të përfaqësuesit do të njoftohet Kryetari i Odës. Me autorizim të Kryetarit të Odës bëhet caktimi i përfaqësuesit tjetër sipas detyrës zyrtare.
6. Nëse Prokurori i çështjes prishë rendin dhe qetësinë apo nuk i pëmbahet udhëzimeve të kryesuesit të seancës, Këshillit Etik i drejtohet me shkrim Kryetarit të Odës për caktimin e përkohshëm të përfaqësuesit të Prokurorisë së Odës. Në rast se shkelja ka të bëjë me zëvendësprokurorin i cili e përfaqëson aktin ankimor, zëvendësimi i tij bëhet sipas detyrës zyrtare nga Prokurori i Odës.

Neni 47

Dëgjimi i dëshmitarëve

1. Dëgjimi i dëshmitarëve bëhet në mënyrë të drejtpërdrejt në mënyrë verbale.
2. Para marrjes në pyetje, dëshmtari njoftohet se është i detyruar që gjatë deklaramit të tij të flas të vërtetën dhe se për deklarimet e tij ai bartë përgjegjësinë ligjore për deklarimet e rrejshme lidhur me çështjet që deklarohet.
3. Këshillit Etik mund të kërkojë nga dëshmitari që të bëjë betimin me tekst si në vijim:
“Me vetëdijen time të plotë për rëndësinë e deklarameve të mija, nën përgjegjësinë time ligjore dhe morale, solemnisht deklaram pranë Këshillit Etik se do ta flas të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, dhe asgjë përveç të vërtetës dhe se nuk do të fshehi asgjë për të cilën jam në dijeni. Betohem.”
Betimi lexohet nga kryesuesi i seancës dhe i njëjti përsëritet nga dëshmitari.
4. Dëshmitari merret së pari në pyetje nga pala e cila është propozuar dhe më pas nga pala kundërshtare.
5. Anëtarët e Këshillit Etik kanë të drejtën që gjatë marrjes në pyetje të kërkojnë sqarime shtesë mbi deklarimet që i bën dëshmitari gjatë përgjigjeve të tij.
6. Nëse anëtarët e Këshillit Etik konsiderojnë se nevojiten sqarimet shtesë, pas përfundimit të marrjes në pyetje të dëshmitarit nga palët, dëshmitari mund të merret në pyetje nga anëtarët e Këshillit Etik.
7. Palët gjatë marrjes në pyetje mund ta ballafaqojnë dëshmitarin me deklaratën e tij nëse e ka dhënë një të tillë më parë apo edhe ta ballafaqojnë me ndonjë provë materiale.
8. Rregullat e marrjes në pyetje të dëshmitarëve zbatohen përshtatshëmrisht edhe në procedurë të marrjes në pyetje të ekspertit.

Neni 48

Angazhimi dhe dëgjimi i ekspertëve

1. Ekspertët angazhohen me propozimin e palëve në procedurë dhe me urdhër të Këshillit Etik.
2. Propozimi i palëve për angazhim të ekspertit miratohet nga Këshilli Etik. Angazhimin e ekspertëve e zbaton Këshilli Etik sipas listës së klasifikuar në bazë të lëmisë përkatëse profesionale. Angazhimi nga lista e ekspertëve bëhet sipas radhës alfabetike për secilën renditje sipas fushës profesionale të ekspertëve.

3. Pas dëgjimit të dëshmitarëve bëhet dëgjimi i ekspertit i cili fillimisht bën prezantimin e konstatimit të tij ekspertik.
4. Në rastet kur eksperti ka hartuar raport në formë të shkruar, lejohet leximi i raportit.

Neni 49 **Administrimi i provave**

1. Pas dëgjimit të dëshmitarëve dhe ekspertit eventualisht të angazhuar, Këshilli Etik administron provat që janë të bashkëngjitura në dosjen e lëndës, përfshirë këtu edhe provat e paraqitura nga i paraqituri apo mbrojtja e tij.
2. Me rastin e administrimit të provave, palët kanë të drejtë të paraqesin vërejtjet e tyre të cilat detyrimisht shënohen në procesverbal.
3. Në rast se ndonjë provë është marrë në mënyrë të kundërligjshme, Këshilli Etik e shpallë atë provë si të papranueshme dhe të njëjtën e veçon nga dosja e lëndës.
4. Pretendimet lidhur me shpalljen të pavlefshme të provës, palët mund të përfshinë kundërshtimin e tyre në vendimin përfundimtar të Këshillit Etik.

Neni 50 **Mbrojtja**

1. I paraqituri ndaj të cilit është ngritur akti ankimor, pas administrimit të provave, merret në pyetje nga Prokurori, pala e dëmtuar apo përfaqësuesi i saj dhe në rast se konsiderohet e nevojshme për sqarime plotësuese edhe nga anëtarët e Këshillit Etik.
2. I paraqituri personalisht apo përmes mbrojtësit të tij, mund të paraqet shënimet e ndryshme si dhe të propozojë prova në kuptim të mbrojtjes së tij.
3. Gjatë gjithë marrjes në pyetje, ndaj të paraqiturit duhet të kihet respekt për dinjitetin e tij dhe ndalohet çfarëdo pyetje e cila supozon pranimin e ndonjë çështje të cilën i paraqituri nuk e ka pohuar.
4. Shkelja e standardit nga paragrafi 3 paraqet shkelje absolute të dispozitave procedurale dhe deklarata e të paraqiturit do të konsiderohet si provë e papranueshme.

Neni 51

Pranimi i fajsisë

1. I paraqituri në çdo kohë deri në përfundimin e shqyrtimit mund të deklarohet për pranimin e fajsisë.
2. Këshilli Etik do t'i jep mundësi të paraqiturit që të konsultohet me mbrojtësin e tij, dhe për këtë ta kërkojë të shtyhet seanca deri në 3 (tre) ditë të ardhshme nga dita e seancës së mbajtur.
3. I paraqituri pranimin e fajsisë mund ta bëj në seancë apo edhe jashtë seancës përmes shkresës së dorëzuar personalisht pranë Shërbimit Profesional.
4. Në rast të pranimin të fajsisë, Këshillit Etik ndërprejnë ndërmarrjen e veprimeve të mëtutjeshme procedurale dhe tërhiqet në senacë të trajtimit dhe votimit.
5. Pranimi i fajsisë paraqet rrethanë lehtësuese dhe me këtë rast Këshilli Etik obligohet që ta ketë parasysh këtë fakt procedural me rastin e caktimit të masës disiplinore.
6. Rregullat nga ky nen zbatohen përshtatshmërisht edhe në procedurën sipas mjetit juridik.

Neni 52

Deklaratat përfundimtare

1. Pas përfundimit të procedurave provuese, kryesusi i seancës fton palët për të dhënë deklaratat përfundimtare lidhur me çështjen.
2. Në deklaratat e tyre përfundimtare palët duhet t'i përmbledhin të gjitha pretendimet e tyre materiale dhe procedurale që ndërlidhen me shqyrtimin e çështjes duke rezervuar të drejtën e elaborimit edhe të provave të parashtruara nga ta. Deklaratat përfundimtare mund të dorëzohen edhe me shkrim, me ç'rast të njëjtat i bashkëngjiten procesverbalit të seancës së shqyrtimit kryesor.
3. Radha e deklaratave përfundimtare fillon me deklaratën e Prokurorit, për të vazhduar me deklaratën e palës së dëmtuar apo përfaqësuesit të saj dhe në fund deklarohet i paraqituri apo mbrojtësi i tij.
4. Palët kanë të drejtë që të paraqesin kundërshtimet e tyre lidhur me deklaratat përfundimtare të palëve kundërshtare dhe për të njëjtat gëzojnë të drejtën e replikës. Deklarimet përfundimtare përfundojnë me deklarin përfundimtar të paraqiturit.

5. Kryesuesi i seancës ka të drejtën e kufizimit kohor të kundërshtimeve të palëve nga paragrafi 4 i këtij neni.

Neni 53

Seanca e trajtimit dhe votimit

1. Pas deklaratave përfundimtare të palëve, Këshilli Etik tërhiqet në seancën e trajtimit dhe votimit. Seanca e tillë është e mbyllur dhe në të nuk mund të marr pjesë asnjëra palë, përjashtimisht personeli i nevojshëm nga Shërbimi Profesional.
2. Sencës e trajtimit dhe të votimit e udhëheq kryesuesi i seancës. Trajtimi fillon me analizën lidhur çështjen kryesore për të cilën është iniciuar procedura, aspektin e përgjegjësisë të paraqiturit për veprimin apo mosveprimin e tij që përbën shkelje të etikës profesionale, shkallën e përgjegjësisë, masën disiplinore që duhet shqiptuar dhe çështjet të tjera që duhet të merren parasysh lidhur me çështjen.
3. Pas analizës në fazën e trajtimit, kryesuesi i seancës e hap votimin lidhur me ekzistimin apo jo të shkeljes etike, për të vazhduar me përgjegjësinë e i paraqiturit për shkeljen e tillë dhe në fund masën të cilën duhet shqiptuar. Konstatimi lidhur me përgjegjësinë e të paraqiturit bëhet nëse për te kanë votuar shumica e të gjithë anëtarëve të Këshillit Etik.
4. Gjatë seancës së trajtimit dhe votimit, Këshilli Etik duhet ta ketë parasysh se vendimi duhet të bazohet vetëm në fakte të mbeshtetura në provat që janë administruar në procedurë.
5. Për seancën e trajtimit dhe votimit Këshilli Etik mbanë procesverbal të veçantë në të cilin evidentohen çështjet e trajtuara dhe votimin e bërë për çështjet e tilla. Procesverbali i tillë nuk është publik.

Neni 54

Shpallja e vendimit

1. Pas seancës së trajtimit dhe votimit, Këshilli Etik shpallë vendimin e nxjerrë në seancë të mbyllur të tillë.
2. Shpallja e vendimit bëhet në prani të palëve dhe personave të lejuar që kanë marrë pjesë në seancën e shqyrtimit kryesor.

3. Tekstin e shpalljes së vendimit e bën kryesuesi i seancës i cili lexon dispozitivin e vendimit, duke dhënë elaborim të shkurtë dhe të përgjithshëm për bazën në të cilën është mbështetur vendimi.

Kapitulli V – Vendimet

Neni 55 Vendimi disiplinor

1. Këshilli Etik nxjerrë vendimin disiplinor me të cilin e shpallë i paraqiturin fajtor duke vërtetuar:
 - 1.1 shkeljen etike për të cilën shpallët fajtor i paraqituri;
 - 1.2 masën disiplinore e cila i shqiptohet të paraqiturit;
 - 1.3 figurën e plotë të veprimit apo mosveprimit që përbën shkeljen etike dhe profesionale; dhe
 - 1.4 Shumën e shpenzimeve të procedurës.
2. Në raste kur të paraqiturit i shqiptohet gjoba, në vendimin disiplinor shënohet afati brenda të cilit duhet shënuar dhe mënyra e pagesës së saj nëse caktohet pagesa në formë të kësteve.

Neni 56 Vendimi shfajsues

1. Këshilli Etik nxjerrë vendim shfajsues me të cilin e liron nga akti ankimor të paraqiturin atëherë kur:
 - 1.1 veprimi për të cilin dyshohet i paraqituri nuk përbën shkelje etike;
 - 1.2 ekzistojnë rrethanat të cilat e përjashtojnë të paraqiturin nga përgjegjësia etike; apo
 - 1.3 nuk është provuar se i paraqituri me veprimin apo mosveprimin e tij ka bërë shkelje të Kodit Etik.

Neni 57 Vendimi refuzues

1. Këshilli Etik nxjerrë vendim me të cilin refuzon aktin ankimor ndaj të paraqiturit atëherë kur:

- 1.1 pala ankuese tërheq ankesën e saj;
- 1.2 prokurori tërhiqet nga ndjekja disiplinore me pajtimin e palës së dëmtuar; apo
- 1.3 është parashkruar shkelja e pretenduar nga palët ankuese.

Neni 58 **Forma e vendimeve**

1. Këshilli Etik nxjerrë vendimin në bazë të formës së përcaktuar sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
2. Vendimet e Këshillit Etik do të përmbajnë detyrimisht pjesën hyrëse, dispozitivin, arsyetimin dhe pjesën përmbyllëse.
3. Në dispozitivin e vendimit shënohen të dhënat personale të të paraqiturit: emrin dhe mbiemrin, adresën e vendbanimit dhe të avokaturës së tij, si dhe vendimin përmes të cilit i paraqituri shpallet përgjegjës për shkeljen disiplinore apo për të cilën ai lirohet nga fletëparaqitja disiplinore. Në rast të disa shkeljeve për të cilat i paraqituri dyshohet dhe për të cilat shpallet përgjegjës, në dispozitivin e vendimit paneli disiplinor çekën masat për secilën shkelje dhe më pastaj çekë masat e plota-masa e njësuar disiplinor. Në dispozitivin e vendimit po ashtu caktohet shuma e shpenzimeve procedurale.
4. Në arsyetimin e vendimit shënohen të gjitha faktet relevante që paraqesin gjendjen faktike dhe provat që kanë mbështetur faktet të tilla mbi të cilat është mbështetur vendimi i Këshillit Etik.
5. Në pjesën përmbyllëse domosdoshmërisht përfshihet udhëzimi juridik për të drejtën e palëve që ndaj vendimit të nxjerrë të paraqesin ankesat e tyre në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të vendimit, pranë Gjyqit të Nderit të Odës.

Kapitulli VI – Procedura sipas mjetit juridik

Neni 59 **Ankesa kundës vendimit të Këshillit Etik**

1. Palët me interes juridik mund të parashtrojnë ankesë kundër vendimit të Këshillit Etik në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita pranimit të vendimit në formë të shkruar.
2. Ankesa kundër vendimit i drejtohet Gjyqit të Nderit.
3. Me kërkesën e Gjyqit të Nderit dokumentacioni i kompletuar për rastin e proceduar dorëzohet nga administrata brenda 7 (shtatë) ditë nga parashtrimi i ankesës.

Neni 60

Përmbajtja e ankesës

1. Krahas të dhënave të përgjithshme lidhur me parashtruesin, ankesa duhet të përfshijë po ashtu:
 - 1.1 Bazën juridike të goditjes së vendimit;
 - 1.2 Arsyetimin e ankesës;
 - 1.3 Propozimin lidhur me anulimin e plotë apo të pjesshëm të vendimit;
 - 1.4 Propozimin për rishqyrtim, nëse këtë e kërkon parashtruesi; dhe
 - 1.5 Data dhe nënshkrimi i parashtruesit të ankesës.

2. Parashtruesi i ankesës mund t'i bashkëngjitë provat shtesë të cilat nuk janë trajtuar gjatë shqyrtimit kryesor. Në këtë rast parashtruesi i ankesës obligohet që t'i tregojë arsyet e mosparaqitjes së provave të paprezantuara gjatë procedurës së shqyrtimit kryesor.

Neni 61

Arsyet e parashtrimit të ankuesit

1. Ankesa kundër vendimit të Këshillit Etik mund të parashtrohet për arsyet si në vijim:
 - 1.1 Shkeljes së dispozitave të procedurës disiplinore të paraparë me këtë rregullore;
 - 1.2 Shkeljes së dispozitave materiale;
 - 1.3 Vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike;
 - 1.4 Vendimit lidhur me masën disiplinore; dhe
 - 1.5 Vendimin për publikimin e vendimit me rastin e shqiptimit të masës së qortimit publik.

2. Me rastin e parashtrimit të ankesës, parashtruesi duhet të arsyetojë secilën nga arsyet e parashtrimit të ankesës me të cilin goditet vendimi i Këshillit Etik.

3. Ankesa nuk mund të parashtrohet për shkak të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike në rastet kur i paraqituri pranon përgjegjësinë lidhur me veprimin për të cilin është zhvilluar procedura.

Neni 62

Procedimi i ankesës

1. Pranimi i ankesës bëhet nga zyrtari i Shërbimit Profesional i Odës i cili regjistron ankesën sipas numrit të protokollit dhe me këtë rast sipas detyrës zyrtare ia dërgon Kryetarit të Këshillit Etik për ta dërguar tek Kryetari i Gjyqit të Nderit me të gjithë dosjen e lëndës.
2. Kryetari i Gjyqit të Nderit shqyrton lejshmërinë dhe përmbajtjen e ankesës dhe nëse ankesa nuk i përmban elementet të parapara me dispozitat e kësaj rregulloreje, ia dërgon parashtruesit për ta bërë precizimin e saj në afat prej 3 (tre) ditëve.
3. Në rast se parashtruesi i ankesës brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni nuk e plotëson ankesën, ankesa e tillë hedhet poshtë si jo e plotë.
4. Nëse ankesa është parashtruar nga personi i pautorizuar ankesa do të hudhet si e palejueshme.

Neni 63

Përgjigja ndaj ankesës

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës sipas dispozitës së Nenit (paraprak) të kësaj rregulloreje, Gjyqi i Nderit përmes Shërbimit Profesional ia dërgon një kopje të ankesës palës kundërshtare në një afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e parashtrimit të ankesës.
2. Pala kundërshtare mund të paraqesë përgjigjen me shkrim në ankesë në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga data e dorëzimit të ankesës.
3. Në rast se pala kundërshtare nuk parashtron përgjigjen në ankesë sipas afatit nga paragrafi 2 i këtij neni, konsiderohet se pala kundërshtare ka hequr dorë nga përgjigja në ankesë.
4. Pas dorëzimit të përgjigjes në ankesë, Shërbimi Profesional përgatit gjithë dosjen e lëndës së bashku me ankesën dhe përgjigjen në ankesë dhe të gjithë materialin e tillë e përgatitë për shqyrtim nga Gjyqi i Nderit. Veprimet e tilla Shërbimi Profesional i bën në koordinim me Kryetarin e Gjyqit të Nderit.

Neni 64

Shqyrtimi i ankesës

1. Shqyrtimi i ankesës mund të bëhet në:

1.1 Seanca të mbyllura; dhe

1.2 Seanca dëgjimore.

2. Shqyrtimi i ankesave në parim bëhet në seancat e mbyllura duke trajtuar çështjen mbi bazën shkrimore të dosjes së lëndës.
3. Seancat dëgjimore mbahen me propozim të palëve kur kjo konsiderohet e nevojshme nga Gjyqi i Nderit, si dhe me kërkesën e anëtarëve të Gjyqit të Nderit kur konsiderohet se ka nevojë të sqarimit të çështjeve në mënyrë të drejtpërdrejt nga ana e palëve.

Neni 65

Seanca dëgjimore

1. Seancat dëgjimore mbahen para Gjyqit të Nderit dhe në mbajtjen e tyre zbatohen rregullat e njëjta lidhur me ftesën e palëve në seancë, pjesëmarrjen e tyre, mbrojtjen, mbajtjen e rendit dhe qetësisë, kohën dhe vendin e seancës, evidentimin e seancës, procedura e trajtimit dhe votimit dhe shpalljes së vendimit të Gjyqit të Nderit.
2. Mosprania e njëres palë në seancë nuk pengon mbajtjen e seancës dëgjimore.
3. Të gjitha rregullat e shqyrtimit kryesor zbatohen përshtatshëm për mbajtjen e seancës dëgjimore.
4. Kryetari i Gjyqit të Nderit hapë seancën dëgjimore duke prezantuar në përgjithësi çështjen dhe pretendimet ankimore.
5. Pas hapjes së seancës dëgjimore, palët mund të ftohen për të dhënë shpjegime të nevojshme lidhur me pretendimet e tyre ankimore.
6. Seanca dëgjimore mbahet vetëm në rastet kur ekziston nevoja për marrjen e provave të reja të cilat nuk janë shqyrtuar në procedurën e shkallës së parë dhe shqyrtimi i tillë ka qenë i pamundshëm për shkaqe të arsyeshme. Rregullat lidhur me dëgjimin e dëshmitarëve zbatohen përshtatshëm edhe në seancën dëgjimore pranë Gjyqit të Nderit.

Neni 66

Vendimi sipas ankesës

1. Gjyqi i Nderit në procedurë sipas mjetit juridik vendos që:
 - 1.1 Të hedhë ankesën si të palejueshme, paafatshme apo jo të plotë;
 - 1.2 Të refuzon ankesën si të pabazuar dhe të vërtetojë vendimin e shkallës së parë;

- 1.3 Të ndryshojë vendimin e shkallës së parë dhe të vendos në mënyrë meritore për çështjen; apo
 - 1.4 Të anulojë vendimin e shkallës së parë dhe çështjen ta kthej në rivendosje.
2. Vendimi i Gjyqit të Nderit përpilohet në mënyrë të shkruar dhe sipas përmbajtjes së njëjtë sipas dispozitave të përmbajtjes së vendimit të shkallës së parë.
 3. Gjyqi i Nderit refuzon ankesën si të pabazë dhe vërteton vendimin e shkallës së parë nëse përcakton se nuk ka bazë për ankimimin e vendimit dhe se nuk ka pasur shkelje të pretenduar.
 4. Gjyqi i Nderit anulon vendimin e shkallës së parë dhe e kthen lëndën për rivendosje nëse vjen në përfundim se ekziston shkelja e rregullave procedurale dhe kur konsideron se seanca e re dëgjimore para organit të shkallës së parë është e nevojshme për shkak të përcaktimit të drejtë apo të plotë të gjendjes faktike.
 5. Gjyqi i Nderit anulon vendimin e shkallës së parë për arsye të përcaktimit të gabuar apo jo të plotë të fakteve edhe pse vendimi nuk ankimohet për arsye nëse gjatë shqyrtimit të ankesës, ngritën dyshime serioze rreth saktësisë së fakteve materiale që janë përcaktuar.
 6. Vendimi i Gjyqit të Nderit ka formë të prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankesa. Palët e pakënaqura me vendimin e Gjyqit të Nderit mund të parashtrorjnë padi pranë gjykatës kompetente për konfliktin administrativ në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh.

Neni 67 **Reformatio in peius**

Në raste kur ankesa është parashtruar vetëm nga ana e të paraqiturit, Gjyqi i Nderit nuk mund të nxjerrë vendim më pak të favorshëm për parashtruesin e ankesës për shkak të kualifikimit juridik të shkeljes dhe masës së shqiptuar në shkallë të parë.

Neni 68 **Procedura e rivendosjes**

1. Në raste kur Gjyqi i Nderit anulon vendimin e Këshillit Etik dhe çështjen e kthen në rivendosje, Këshilli Etik zhvillon shqyrtimin në bazë fletëparaqitjes apo propozim-ankesës së parashtruar nga prokurori apo ankesës së parashtruar nga palët e autorizuara.
2. Në procedurën e rivendosjes Këshilli Etik do t'i trajtojë vetëm çështjet që janë kontestuar në procedurë sipas mjetit juridik dhe gjatë procedurës së rivendosjes palët kanë të drejtë të paraqesin prova të reja që nuk janë trajtuar më parë në procedurë.

Kapitulli VII – Procedura sipas mjetit të jashtëzakonshëm

Neni 69

Kërkesa për rihapjen e procedurës

1. Pala e cila ka humbur afatin për parashtrimin e ankesës, mund të parashtrojë kërkesën për rihapjen e procedurës.
2. Kërkesa për rihapjen e procedurës mund të paraqitet vetëm në rastet kur parashtruesi i kërkesës është vënë në dijeni me ekzistimin e njëres nga këto arsye:
 - 2.1 gjendja faktike mbi të cilin bazohej vendimi i kundërshtuar, ka ndryshuar në favor të palës;
 - 2.2 janë zbuluar prova të reja, të cilat, po të kishin qenë të ditura në kohën e vendimmarrjes, mund të kishin ndikuar në lëshimin e aktit të administrativ të kundërshtuar;
 - 2.3 pas lëshimit të aktit, ka ndryshuar praktika administrative për çështje të njëjta apo të ngjashme administrative.
3. Kërkesa për rihapjen e procedurës nuk mund të paraqitet nëse mosnjohja e shkaqeve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni është bërë nga neglizhenca e palës.

Neni 70

Afati dhe kërkesa

1. Kërkesa për rihapjen e procedurës administrative mund të paraqitet jo më vonë se një (1) vit nga njoftimi i aktit.
2. Kërkesa për rihapjen e procedurës i parashtrohet dhe shqyrtohet nga Këshilli Etik, si organ i shkallës së parë që ka nxjerrë vendimin ndaj të cilit paraqitet kërkesa për rihapjen e procedurës.
3. Dispozitat mbi përmbajtjen e ankesës, do të zbatohen, përshtatshmërisht edhe për kërkesën për rihapjen e procedurës.

Neni 71

Vendimi sipas kërkesës për rihapje të procedurës

1. Gjyqi i Nderit, nëse pas shqyrtimit të kërkesës për rihapjen e procedurës administrative, vlerëson që, po të merrej në konsideratë shkaku i rihapjes, vendimi i nxjerrë do të kishte qenë i paligjshëm apo i papërshtatshëm, ai anulon apo ndryshon vendimin, gjegjësisht nxjerr vendimin refuzues. Në çdo rast të kundërt, refuzon kërkesën për rihapje.

Gjyqi i Nderit lëndën në rishqyrtim mund ta rikthejë në organin i cili ka nxjerrë vendimin.

Kapitulli VIII – Procedura në shkallë të parë pranë Gjyqit të Nderit

Neni 72

Kompetenca lëndore

Gjyqi i Nderit vendos për çështjet që ndërlidhen me anëtarët e Odës dhe parregullësive në procesin zgjedhor të organeve të Odës.

Vendimet e Gjyqit të Nderit janë përfundimtare.

Neni 73

Inicimi i procedurës pranë Gjyqit të Nderit

1. Të drejtën e inicimit të procedurës pranë Gjyqit të Nderit kanë të gjithë personat që kanë interesin juridik në përputhje me kompetencën lëndore të përkufizuar me Nenin 29 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe Nenin 73 të kësaj rregulloreje.
2. Lëndët e proceduara pranë Gjyqit të Nderit për çështje zgjedhore nuk përfaqësohen në asnjë rast nga Prokurori i Odës në kuptim të natyrës lëndore si procedurë e veçantë e paraparë me këtë rregullore.

Neni 74

Procedura pranë Gjyqit të Nderit

1. Procedura në çështjet që shqyrtohen nga Gjyqi i Nderit zbatohen përshtatshëm rregullat procedurale të parapara me këtë rregullore
2. Procedura sipas mjetit juridik nuk është e lejuar ndaj vendimeve të Gjyqit të Nderit, ndërkaq vendimet e nxjerra nga Gjyqi i Nderit mund të kontestohen në procedurën e konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente.
3. Procedura sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik është e lejuar ndaj vendimeve të Gjyqit të Nderit. Dispozitat nga Kapitulli VII i kësaj rregulloreje do të jenë të zbatueshme përshtatshëm nga Gjyqi i Nderit në procedurë sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik.

Kapitulli IX – Shpenzimet e procedurës

Neni 75

Llojet e shpenzimeve të procedurës

1. Shpenzimet e procedurës përfshinë shpenzimet që shkaktohen gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore.

2. Në kuadër të shpenzimeve të procedurës përfshihen këto shpenzime:
 - 2.1 Shpenzimet lidhur me pagesën e taksës procedurale;
 - 2.2 Shpenzimet lidhur me angazhimin e ekspertit;
 - 2.3 Shpenzimet paushallë të procedurës.
3. Shpenzimet nga paragrafi 2 i këtij neni, duhet të arsyetohen me dokument financiar apo cilëndo dëshmi e cila vërteton faktin e shkaktimit të shpenzimit.

Neni 76

Barra e shpenzimeve të procedurës

1. Palët bartin shpenzimet procedurale paraprakisht deri në përfundimin e procedurës.
2. Me vendimin me të cilin përfundon procedura disiplinore caktohet barra e shpenzimit të procedurës.
3. Barra e kompensimit të shpenzimeve të procedurës caktohet varësisht nga përfundimi i procedurës disiplinore.
 4. Taksa për iniciimin e procedurës aplikohet vetëm për anëtarët e OFK-së.

Kapitulli IX – Përmbartimi i vendimeve të formës së prerë

Neni 77

Ekzekutshmëria e vendimeve

1. Vendimet që nxjerrën nga organet e mbikëqyrjes etike marrin formën e prerë me kalimin e afatit për ushtrimin e së drejtës në ankesë.
2. Vendimi i cili ka marrë formën e prerë mund të ekzekutohet përmes nxjerrjes së urdhrit për ekzekutim. Urdhri për ekzekutim nxjerrët nga organi i cili ka nxjerrë vendimin, të cilin ia dërgon palës si njoftim për afatin e ekzekutimit të vullnetshëm.
3. Afati për ekzekutimin e vullnetshëm sipas paragrafit 2 të këtij neni, është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita që pala është njoftuar për urdhrin për ekzekutim.
4. Rregullat për njoftimin e palës do të zbatohen përshtatshëmrisht me dispozitat e kësaj rregulloreje përkitazi me ftesat që u dërgohen palëve.

Neni 78
Përmbartimi i vendimeve

1. Vendimet që janë të ekzekutueshme, ekzekutohen nga vetë organi që ka nxjerrë urdhërin për ekzekutim.
2. Vendimet të cilat për nga natyra e tyre nuk mund të ekzekutohen nga organi i cili ka nxjerrë vendimin, për të njëjtat do të iniciohet procedura përmbartimore në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbartimore.
3. Propozimi për përmbartim përgatitet dhe nënshkruhet nga Kryetari i organit i cili ka nxjerrë vendimin i cili është bërë i ekzekutueshëm.

Neni 79
Përmbajtja e urdhërit

1. Urdhri për ekzekutim do të ketë këtë përmbajtje:
 - 1.1 Emërtimin e organit që nxjerrë urdhrin;
 - 1.2 Vendimi i cili duhet ekzekutohet;
 - 1.3 Të dhënat mbi të paraqiturin që duhet ta ekzekutojë vendimin;
 - 1.4 Përshkrimin e procedurës që duhet ndjekur për ekzekutim;
 - 1.5 Afatin për ekzekutim të vullnetshëm, nëse është caktuar;
 - 1.6 Organi i cili ngarkohet me ekzekutim në përputhje me dispozitat e Nenit 81 të kësaj rregulloreje; dhe
 - 1.7 Udhëzimet lidhur me mënyrën dhe kohën e ekzekutimit kur kjo kërkohet.

Neni 80
Procedura e ekzekutimit nga organi

1. Varësisht nga lloji i masës disiplinore, organi që ka nxjerrë vendimin për ekzekutim, pasi që ta ketë nxjerrë urdhërin për ekzekutim dhe ka kaluar afati për zbatim të vullnetshëm, njofton me shkrim Shërbimin Profesional për veprimet që duhet ndërmarë për tu ekzekutuar vendimi i tillë.
2. Në rastet kur kemi të bëjmë me shqiptimin e masës së qortimit publik, organi do t'a udhëzojë Shërbimin Profesional që masën e tillë ta bëjë publike në ueb faqen zyrtare të Odës.
3. Kur organi ka shqiptuar masën disiplinore të arsimimit shtesë dhe të detyrueshëm pasuniversitar dhe trajnimit të detyrueshëm nga droga, alkooli dhe vese të tjera, kur pala nuk ka përmbushur detyrimet sipas vendimit, atëherë do të kërkojë nga Komisioni për licencim që konform vendimit që ekzekutohet, të bëjë revokimin e licencës sipas afatit siç është caktuar me vendimin me të cilin është shqiptuar masa disiplinore.
4. Masa disiplinore që ka të bëjë me tërheqjen e përkohshme apo të përhershme të licencës dhe fshirja e Farmacistit nga regjistri të cilin e mirëmban Oda, ekzekutohet nga Komisioni për Licencim i Odës. Kjo dispozitë është e zbatueshme edhe tek rastet e parapara me paragrafin 3 të këtij neni.

5. Në rastet e shqiptimit të masës disiplinore të shprehura në vlerë monetare, në rast të moszbatimit të vullnetshëm të vendimit, organi përgatit propozimin për përmbarrim pranë organit kompetent në përputhje me paragraf 2 të Nenit 79 të kësaj rregulloreje.

Neni 81

Zbatimi i gjobave shtrënguese për ekzekutim të masës disiplinore në të holla

1. Në raste kur i paraqituri ndaj të cilit është shqiptuar masa disiplinore në të holla nuk e përmbush detyrimin sipas urdhërit për ekzekutim, përmbushja përmbarrimore e masës së tillë bëhet përmes gjobës shtrënguese për të cilën paralajmërohet i paraqituri përmes urdhërit për ekzekutim.
2. Vlera e gjobës detyruese nga paragrafi 1 i këtij neni, do të jetë nga dhjetë përqind (10%) e gjobës së shqiptuar për çdo vonesë në muaj.
3. Gjoha shtrënguese sipas paragrafit 2 të këtij neni do të llogaritet deri në kohën e nxjerrjes së urdhërit për përmbarrim nga organi kompetent.

Kapitulli X – Dispozitat kalimtare

Neni 82

Çështjet e iniciuara pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të procedohen sipas dispozitave të kësaj rregulloreje. Çdo ndryshim eventual me rastin e miratimit të saj nga Kuvendi i OFK-së do të zbatohet në favor të palës kundër të cilës është iniciuar procedura.

Neni 83

Në takimet e Gjyqit të Nderit merr pjesë sekretari i OFK-së.

Neni 84

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OFK-së.

Prishtinë, 21.12.2019

Kryetari i OFK-së
Dr.Sc. Arianit Jakupi

